

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, me përkthyes Osman Zymberi në çështjen penale ndaj të pandehurit Ll.C., nga ..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-s¹, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjiilan, PP.II.nr.1178/2016, të datës 07.07.2016, të cilën e përfaqëson prokurori Shefik Memeti, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 18.04.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Ll.C., nga babai Zh., e ëma C. e lindur P., i lindur ... në Gjiilan, me vendbanim në fsh ..., ka të kryer shkollën e mesme, punon si kamarier, i pa martuar, i gjendjes ekonomike të mesme, Serb, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më datën 20.02.2016, në lokalin e tij në Partesh, i pandehuri me qëllim që vetit ti sjell përfitim të kundërligjshëm pasuror, nga rrjeti i të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Gjiilan, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që i njëjti i ka bërë një degëzim të përçuesve në energjinë elektrike jashtë pikës matëse-njehsorit elektrik, dhe në këtë mënyrë energjia elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar fare, me çka ka dëmtuar KEDS-in Distribuimi në Gjiilan, në shumë prej rreth 3.240 Euro

me çka ka kryer veprën penale, Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 46, 50, 51, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarin:

E G J Y K O N

Të akuzuarit Ll.C., i caktohet dënimi kumulativ me burg në kohëzgjatje prej 100 (njëqindë) ditë i cili nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqindë) euro, i cili dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri refuzon të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtim me të pandehurin zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20.00 € (njëzet euro), ndërsa nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënitimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20.00 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

¹ **Kodi Penal i Republikës së Kosovës** (Në tekstin e mëtejshëm **KPRK**), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën pre 20.00 € (njëzetë euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit Ll.C., nga ..., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-s.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, të mbajtur më datën 18.04.2018 Prokurori i shtetit Shefik Memeti, gjatë fjalës përfundimtare, ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës lëndore, duke i propozuar gjykatës të pandehurin Ll.C., ta shpall fajtor dhe ta dënojë sipas Kodit penal, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për mbështetje ligjore të dënimit të shqiptuar.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës S.M. në fjalën përfundimtare deklaroi: e mbështesë në tërësi fjalën e PSH, I bashkohem ndjekjes penale, ndërsa për vlerën e demit si rrjedhojë e veprës penale në shumë prej 3.240.46 € paraqesim kërkesë pasuroro – juridike

I akuzuari Ll.C., në fjalën përfundimtare deklaroi: nuk e ndijë veten fajtor, pasi që unë nuk e kam kryer këtë vepër penale dhe tjetër nuk kam qka të shtoj.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike: se është vërtetuar se i akuzuari Ll.C., e ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-s.

Këtë gjendje faktike, gjykata e konstatoi duke u bazuar në këto prova:

- Dëshmia dhe deklaratat e dëshmitarve B.B., Xh.M., V.H. dhe A.L.
- Proccesverbali i KEDS-it me nr. serik 1265372 të datës 20.02.2016,
- Fatura DGL16HP05028 i datës 23.02.2016
- Kalkulimi i RH me nr.40814 i datës 23.02.2016
- Fotografit e njehsorit, instalimit elektrik dhe objektit nga vendi i ngjarjes.

Dëshmitari **B.B.** puntor i KEDS deklaroi se më datë 20.02.2016 kemi qenë në fsh Partesh për ti kontrolluar humbjet në teren, gjatë kontrollimit ne kemi arritur te lokali i M.S. ku une kam qenë me kolegët Xh.M., V.H. dhe A.L.. Ne jemi afruar te njëtori elektrik dhe kemi parë se njëtori, pas kësaj objekti është dashur të mos ketë energji, mirpo gjatë kontrollimit të lokalit ne hasëm në një kabëll e cila ka qenë i lidhur jashtë pikës matëse. Në atë kabëll konsumatori e ka keqpërdorur energjinë elektrike ku kemi konstatuar se keqpërdorimi është bërë me aparat kafe, mullirin e kafes dhe hidroforit, hargjimet e të cilave janë të mëdha. Konsumatori ka mundur ti shfrytëzojë edhe paisjet tjera elektrike në këtë kablo por ne jemi bazuar vetëm në spinat(shtekerat) ku kanë qenë të kyqura këto paisje. Në vendin e ngjarjes kemi bërë foto, përveq meje edhe tre kolegët e mi e kanë parë këtë ngjarje. Sa më kujtohet mua prezentë ka qenë tani i akuzuari në sallë i cili na ka thënë se shfrytëzuesi i lokalit jam unë ndërsa pronar i lokalit është M.S., prej të cilit e ka marrë këtë lokal me qera. Nuk më kujtohet saktë, por për këtë është deklaruar tani qiramarrësi Ll. dhe i cili thot se unë në këtë lokal kam qenë që nga fundi i vitit 2013. Dëmi i shkaktuar prej 3.240 euro është llogaritur nga shërbimi llogaritor i KEDS dhe gjatë gjithë kohës Ll.C. ka qenë prezentë gjatë kontrollit dhe ne ja kemi shpjeguar rastin se si është kryer keqpërdorimi. Unë nuk e di më kënd ka pasur kontrat i akuzuari.

Dëshmitari Xh.M. deklaroi: Punoj në KEDS prej vitit 2002, qe 10 vite punoj në vendin e punës kontrollor i njëtorëve elektrik dhe humbjeve, ne e kontrollojmë shfrytëzimin e energjisë elektrike edhe në fsh. Partesh, më dt.20.02.2016 kemi qenë në Partesh për kontrollim të njëtorëve, sipas

urdhëresës dhe gjatë kontrollimit në lokalin i cili ka qenë në emër të M.S. ka qenë jashtë lokalit i cili ka qenë i pa bllobuar por ka qenë në gjendje të rregullt. Sipas procedurave ne e kemi ndërprerur njësorin elektrik dhe gjatë kontrollimit mbrenda në lokal dmth ka pas në një pjesë të lokalit energji elektrike edhe pse nuk është dashtë me pas.kemi bërë fotografi të lokalit dhe i kemi treguar se kjo është lidhje direkte e pa autorizuar e cila nuk e bënë matjen e energjisë së shfrytëzuar. E kemi përpiluar procesverbalin në vendin e ngjarjes ku i kemi shënuar paisjet elektrike të cilat i njëjti i ka shfrytëzuar në këtë lokal, një kopje të procesverbalit ia kemi dorëzuar palës. Në lokal na kanë thënë se shfrytëzues i energjisë elektrike është Ll.C.. Ne i kemi treguar hargjuesit arsyen pse kemi shkuar, lokali ka qenë në kuadër të objektit për banim por nuk e dijmë a ka banuar. Ky njësor ka regjistruar vetëm energjinë në lokal.Ll. ka qenë prezentë por nuk e ka nënshkruar procesverbalin Ne nuk i kemi kontrolluar shpenzimet e këtij konsumatori pas këtij rasti pasi që kjo nuk është detyrë e jonja. Nuk më kujtohet a kemi pyetur për kontratën për qiramarrje. Ne e dimë që ai që e shfrytëzon edhe e paguan. Nuk më kujtohet a e kemi eliminuar këtë keqpërdorim, por e dijmë se rrymën në lokal ia kemi ndërprerë.

Dëshmitari **A.L.** deklaroi; më 20.02.2016 sipas urdhëresës kemi shkuar në fsh. Partesh me kontrollu njësorët elektrike dhe paisjet elektrike. Gjatë kontrollës në lokalin byfe M.S., shfrytëzues ka qenë Ll.C., në fillim njësorin i cili ka qenë i pa bllobuar e kemi ndërprerë dhe pas kësaj kemi hyrë në lokal për ti kontrolluar paisjet dhe instalimin dhe me këtë rast e kemi vërejtur se në këtë lokal është një lidhje direkte jashtë pikës matëse ku është bërë hargjimi i pa autorizuar i cili nuk është regjistruar në njësor. Kjo shifet edhe në fotot të cilat i kemi bërë në vendin e ngjarjes, pas kësaj ne e kemi përpiluar procesin të cilin shfrytëzuesi edhe pse ka qenë prezentë nuk e ka shfrytëzuar, e kemi bllobuar njësorin, ndërsa nuk më kujtohet a e kemi eliminuar lidhjen direkte apo jo. Kontrolla ka qenë rutimore pasi që në trafë ka pasur humbje të energjisë elektrike, kontrollen e kemi bërë edhe në amvisni. Në këtë rast e kemi bërë edhe regjistrimin e paisjeve edhe ato vetëm ato të cilat kanë qenë në këtë lidhje direkte. Kablla ka qenë nën shkallë. Ne e bëjmë kontrollin për me konstatue shfrytëzimin e pa autorizuar të energjisë elektrike. Nuk më kujtohet seksioni i kabllor por e dijmë që ka qenë kablo e trashë me të cilin ka mundur ti furnizojë këto paisje

Dëshmitari **V.H.** në shqyrtimin gjyqësor deklaroi unë jam me profesion elektrikist, punoj në KEDS prej vitit 2002, detyrat e punës janë kontrollimi i njësorve elektrik dhe instalimit në vitin 2016 kemi qenë për kontroll në Partesh së bashku me kolegët e mijë dhe kur kemi shkuar te lokali – kafiteri në emër të M.S., kemi hyrë aty ju kemi treguar punëtorëve prezentë se duhet ta kontrollojmë njësorin, në fillim e kemi bërë shkyqjen e energjisë në objekt edhe ate në njësor dhe pas shkyqjes kemi hyrë mbrenda dhe kemi kontrolluar se mos ka energji elektrike dhe nën shkallë kemi vërejtur një prizë e cila ka pas ende energji elektrike e që nuk duhet të kishte, sepse rryma ka qenë e shkyqur dmth kjo prizë ka qenë e lidhur jashtë njësorit elektrik dhe kjo kabëll nuk ka qenë e kyqur në asnjë njësor. I kemi regjistruar disa aparate të cilat kanë qenë në afërsi të kësaj prize dhe kemi menduar se ka mundur ti shfrytëzojë në këtë prizë edhe pse ka pasur edhe paisje tjera. Kjo lidhje ka qenë në një mur prapa njësorit. Kabllon e kemi këputur deri në mur por mbrenda murit jo. Në ndërkohë ka ardhur shfrytëzuesi Ll. të cilin e kemi njoftuar për lidhjen ilegale që ekziston në lokalin të cilin e shfrytëzon. Rexhistrimin e paisjeve e bëjmë për shkak të llogaritjes të energjisë të pa autorizuar. Procesin nuk e ka nënshkruar me arsyetim se lokali është pronë e tjetër kujt.

I pandehuri gjatë marrjes në pyetje në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklarua se: me dt.20.02.2016 në fillim nuk kam qenë prezentë kur punëtorët e KEDS kanë ardhur në lokal pas një kohe punëtorët më kanë ftuar që të vijë në lokal pasi që kanë ardhur punëtorët e KEDS dhe unë kam ardhur në lokal, ata mua nuk më kanë spjeguar asgjë lidhur me këtë rast dhe nuk më kanë pyetur por vetëm ma kanë dhënë procesin dhe më kanë thënë se duhet ta nënshkruaj procesin pasi që në lokal kemi gjetur vjedhje të energjisë, dhe në lokal më kanë treguar lidhjen e pa autorizuar dhe unë iu kam thënë se kështu ka qenë dhe se unë nuk kam prekur asgjë dhe tjetër nuk kam qka të deklaroj, lokali të cilin e shfrytëzoj nuk është pronë e imja por e M.S. I cili është I ndjer dhe unë e shfrytëzoj si kafene, unë së bashku me dy vëllezërit e mijë punoj aty, të cilin e kam të regjistruar në emër timin, në këtë lokal unë e zhvilloj këtë biznes prej vitit 2014. Nuk kemi kontratë të shkruar me shkrim por

marveshje gojore dhe ate me të ndjerin M.S. i cili ka vdekur në janar të vitit 2016, I cili nuk ka pasardhës dhe tani qiranë ia paguaj motrës së tij me të cilën nuk kam kontratë, shpenzimet e energjisë elektrike I paguaj unë, të cilat vijnë në emër të M.S. dhe ka qenë marveshja me motrën e tij që unë ti paguaj faturat e energjisë elektrike. Fotografitë janë nga lokali im por unë nuk iu kam kushtuar kujdes, qysh I kam gjetur edhe I kam shfrytëzuar. Në lokal kam aparat kafes, mulli dhe hidrofor dhe aparatet tjera të cilat I shfrytëzoj, nuk e kam ditur se rryma që vie përmes këtyre dy prizave nuk regjistrohet në njëisor elektrik. Unë këtë gjendje e kam gjetur nga paraardhësi im I cili e ka shfrytëzuar këtë lokal.

Gjykata pas vlersimit të mbrojtjes së të pandehurit, vlersimit detal të provave të administruara me dëgjimin e dëshmitarëve: B.B., Xh.M., A.L. dhe V.H., si dhe me leximin e provave materiale: Prcesverbali i KEDS-it me nr. serik 1265372 të datës 20.02.2016, Fatura DGL16HP05028 i datës 23.02.2016, Fatura e rikthimit të humbjeve e datës 23.02.2016, Fotografia e njehsorit nga vendi i ngjarjes.

Gjyqtari i vetëm gjykues deklarates së dëshmitarëve ocular: B.B., Xh.M., A.L. dhe V.H. ia fali besimin e plotë sepse deklarata e të njejtëve janë të logjikshme të plota dhe të drejta, meq në pika relavante përputhen mes vete edhe me e Prcesverbali i KEDS-it me nr. serik 1265372 të datës 20.02.2016, Fatura DGL16HP05028 i datës 23.02.2016, Fatura e rikthimit të humbjeve e datës 23.02.2016, Fotografia e njehsorit nga vendi i ngjarjes që gjenden në shkresa të lëndës si dhe pjesërisht edhe me deklaratën e të pandehurit, i cili ka deklaruar se është e vërtetë se puntorët e KEDS-it kanë ardhur në lokalin tim të cilin e kam me qera dhe më kanë treguar lidhjen e pa autorizuar por une të njejtëve u kam thënë se këtë lidhje e kam gjetur kështu kur e kam marr lokalin me qera dhe une e kam shfrytëzuar ashtu si e kam gjetë .

Gjykata e shton besimin se vërtetë i pandehuri e ka shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar energjinë elektrik meq edhe një pjesë e mbrojtjes së të pandehurit përputhet me deklaratat e dëshmitarëve ku i akuzuari delaron se është e vërtetë se puntorët e KEDS-it atë dite në lokalin ku punojë une kan gjetur nje lidhje te pa autorizuar, po unë nuk e kam ditur se egziston kjo lidhje e pa autorizuar dhe une e kam shfrytëzuar ate lidhje ashtu si e kam gjetur dhe se une që nga viti 2014 e kam këtë lokal me qera.

Ky motiv i të pandehurit gjendjen faktike lidhur me këtë qështje penale e bënë më të besushme dhe më të plotë si tezë të vërtetuar nga gjykata përtej dyshimit të bazuar mirë.

Mbrojtjes së të pandehurit gjykata nuk ia fali besimin sepse e njehta është në kundërshtim me provat të cilave kjo gjykatë ju fali besimin dhe se mbrojtja e të pandehurit është e pa logjikshme, jo e besushme dhe se me këtë mbrojtje i pandehuri ka pasur për qëllim vetëm që gjykatën ta vëj në lajthim, sa për tui shmangur përgjegjesisë penale lidhur me veprën penale lëndore.

Gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të provave që jua fali besimin e plotë, vërtetoi gjendjen faktike sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit është përmbushur elementi objektiv. Vjedhja e shërbimeve komunale nga ana e të pandehurit. Pastaj elementi subjektiv i cili konsiston në dashjen direkte, meq i pandehuri e ka bërë lidhjen direkte jashtë njehsorit elektrik me qëllim që njehsori elektrik mos të regjistroj energjinë e shpenzuar elektrike edhe pse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e ndaluara të tij.

Gjykata nuk ka vërtetuar asnjë rrethanë e cila do ta përjashtonte ose esencialisht do ta zvogëlonte përgjegjësinë penale të pandehurit, andaj edhe ka vërtetuar se i njejtë është përgjegjës penalisht për veprën penale lëndore meq ka poseduar aftësinë mendore përkatsisht për gjykim.

Duke pasur parasysh provat të cilave kjo gjykatë ia fali besimin vërtetoi se në veprimet e të pandehurit janë përmbush të gjitha tiparet e figurës së veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK, duke e shpallur fajtor dhe denuar të njëjtin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit në kuptim të nenit 73 të KPRK-s, pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ndaj të akuzuarit, si rrethana lehtësuese mori parasysh: sjelljen korrekte në gjykatore, më parë nuk ka qenë i gjykuar, kurse si rrethana rënduese, shkalla e përgjegjësisë penale, rrezikshmëria shoqërore dhe dëmi i shkaktuar të dëmtuarës.

Duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartë cekura gjykata, është bindur se me një dënim komulativ me gjobë prej 300 euro, dhe dënim me kusht mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KP-s, se ky dënim është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe do ta parandalonte të akuzuarin që të mos kryej vepra penale.

Në kuptim të nenit 368 të KPP-s, palët u njoftuan se kanë të drejtë në ankesë, i cili udhëzim u shënuar në procesverbal.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-s.

Për arsyet e lartcekura u vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 841/2016, Më 18.04.2018

Sekretarja juridike,
Igballe Azemi d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.